



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 56/2023 (JR)
Nr. 56/2 regj.

Tiranë, më 10.09.2024

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se, ditën e hënë në datën 30.09.2024, ora 10:00, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri nr. (JR) 56/2023, datë 01.12.2023, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 703 datë 28.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Suela Salavaçi.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjyqësor
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Natasha Mulaj
Ina Rama
Mimoza Tasi
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publik.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKËS
GJYQTARE

NATASHA MULAJ

